

Të nderuar...

Sot, kur shënojmë Ditën Ndërkombëtare të Lirive dhe të Drejtave të Njeriut dhe 70-të vjetorin e miratimit të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, më shumë se kurdo qoftë e kujtojmë të drejtën e pakontestueshme të barazisë së njerëzve, peshën dhe garancitë e të drejtave të njohura për gëzimin e barabartë të të njëjtave, pa kurrfarë diskriminimi.

Të gjithë ne, mbrojtësit dhe luftëtarët për liritë dhe të drejta të njeriut, e kuptojmë rëndësinë e këtyre vlerave dhe jo rastësisht jemi të zëshëm në këto kohë turbulente të shfaqjes së krizave, të vetëdijshëm se vetvetiu krizat bartin rreziqe të mëdha të shkeljeve të të drejtave të njeriut.

Duke e marrë parasysh konceptin e demokracisë si bazë të parimit mbi të cilin qëndrojnë liritë dhe të drejtat, në këtë rast dua ta përmend Kartën e Madhe të Lirisë (Magna Carta Libertatum), - dokument të cilin historia e njeh si bazë të kushtetutave të demokracive të zhvilluara në botë, por edhe si bazë për miratimin e Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut.

Kjo Deklaratë është fundament i shumë marrëveshjeve ndërkombëtare, ligjeve nacionale dhe ndërkombëtare, por gjithashtu është edhe themel për institucionet nacionale, rajonale dhe subnacionale, të cilat i promovojnë dhe mbrojnë të drejtat e njeriut.

Në këtë kontekst, Ne, mbrojtësit e të drejtave të njeriut, kjo Deklaratë na inspiron të angazhohemi, të punojmë në mënyrë më efikase dhe në mënyrë më cilësore t'i mbrojmë qytetarët. Për shkak se universaliteti i vlerave, të bazuara në këtë dokument dhe të pranuar nga shtetet, sigurojnë një botë humane dhe të drejt, në të cilën barazia, drejtësia dhe dinjiteti njerëzor janë imperativi kryesor i jetesës.

Të nderuar,

Mbrojtja e lirive dhe të drejtave të njeriut kërkon vigjilencë, përkushtim dhe këmbëngulje në përpjekjet për përmirësimin dhe avancimin e të njëjtave. Këtë e kemi mirë të njohur, për arsyen e thjeshtë se si Avokati i Popullit edhe avokatët janë përkrahës të cilët i kundërshtojnë parregullsitë në shoqëri, duke vepruar nga pozita e pavarësisë dhe profesionalizmit si virtyte të sundimit të së drejtës.

Funkcioni ynë ka ngjashmëri të shumta, dhe përveç profesionalizmit nënkupton edhe përgjegjësinë, etikën dhe moralin në veprim. Në një farë mënyre, ne jemi ura që i lidhë qytetarët me drejtësinë.

Edhe pse ndonjëherë fitohet përshtypje se jemi në anë të ndryshme – Ju si avokatë ta dëshmoni drejtësinë, ndërsa Ne Ombudsmanët padrejtësinë, në esencë e kryejmë misionin e njëjtë: interesin e qytetarëve dhe ndihmojmë në dëshmimin e të drejtës, përkatësisht drejtësisë.

Në të vërtetë, nëse Avokati i Popullit, duke e ndjekur gjendjen me liritë dhe të drejtat e qytetarit e parandalon shkeljen e të njëjtave, duke i vënë në dukje dhe duke dhënë mendime në lidhje me mbrojtjen dhe avancimin e legjislacionit, avokati duke i mbrojtur të drejtat dhe interesat e klientëve, gjithashtu, ndeshet dhe parandalon konflikte, kujdeset që të njëjtat të zgjidhen në përputhje me parimet e pranuar juridike, duke e mbrojtur lirinë, drejtësinë dhe sundimin e së drejtës.

Prandaj, në qendër të vëmendjes së profesioneve dhe mandateve tona janë të drejtat e njeriut, ndërsa në sytë e atyre, të cilët i mbrojmë ose kujdesemi, ne jemi siguria e tyre, duke kërkuar drejtësinë kundrejt padrejtësisë, për çka duhet ta fitojmë besimin e tyre.

Njëra nga të drejtat fundamentale të njeriut është e drejta e qasjes së barabartë në drejtësi dhe gjykimin të ndershëm. Ose, siç thotë saktësisht Deklarata Universale: “Çdokush ka të drejtë të barabartë për gjykim të drejtë dhe publik para një gjykate të pavarur dhe të paanshme.”

Kjo vlerë themelore nënkupton imperativ për besimin në të drejtën dhe funksionimin e pavarur të sistemit të jurisprudencës. Qytetarët duhet të ndihen të sigurt se institucionet në mënyrë konsekuente i zbatojnë ligjet, se ato vlejné njësoj për të gjithë dhe se drejtësia është e aksesshme, përkatësisht e arritshme për të gjithë, ky është obligim i përbashkët i ynë, dhe prandaj gjyqësori duhet të jetë garant për sigurinë juridike. Për këtë qëllim, obligim i autoriteteve është të sigurojnë kushte për funksionimin e tij papengesë, të çliruar nga çdo lloj kufizimi partiak-politik. Aty ku fillon politika përfundon drejtësia.

Për fat të keq, tek ne, në vazhdimësi kemi probleme pikërisht në fushën e pavarësisë së gjyqësorit dhe sundimit të së drejtës. Thuaja se në të gjitha raportet e organizatave ndërkombëtare theksohet ky problem, e që gjithsesi vepron në mënyrë

frustruese për të gjithë, veçanërisht për qytetarët e zakonshëm të cilët e humbin sigurinë juridike dhe besimin në gjykim të drejtë.

Tanimë dy mandate e udhëheq institucionin, dhe domosdo ballafaqohem me mijëra lëndë dhe raste të qytetarëve të pakënaqur nga puna e administratës dhe sidomos gjyqësorit. Problemet dhe perceptimet e tyre janë përfshirë në raportet vjetore.

Konsideroj se në një shtet që proklamohet si juridik dhe demokratik, qytetarë nuk meritojnë të kenë institucione të këtilla. Kjo tregon se me të vërtetë kemi probleme shumë serioze, të cilat kërkojnë zgjidhje të shpejtë, që e vënë në pah nevojën për ndryshime thelbësore në administratë dhe sistemin e jurisprudencës. Thjeshtë, nuk guxojmë të lejojmë improvizime.

Të nderuar,

Avokati i Popullit, kohë më parë, fitoi mandat të veproj si “Mik i gjykatës”, e që si risi, besoj fuqishëm se do të jetë me dobi edhe për qytetarët edhe për organet e jurisprudencës. Në të vërtetë, prezenca e Avokatit të Popullit gjatë ndarjes së drejtësisë, përkatësisht pjesëmarrja në të gjitha fazat e procedurës, me të drejtë që të informohet për seancat e caktuara gjyqësore, të bëjë këqyrje në shkresa dhe në mënyrë aktive të merr pjesë në procedurë, me të drejtë të kërkoj dhe të jep propozime, mundet vetëm të ndihmojë në procesin sundimit të së drejtës dhe kthimit të besimit të qytetarëve në institucionet e jurisprudencës.

Prandaj, është me rëndësi të madhe ta rrisim dhe ta përforcojmë bashkëpunimin tonë të ndërsjellë. Vetëm me veprime të ndërsjella do të mund të presim që qytetarët të kenë besim tek ne, dhe të ndihen të sigurt dhe të mbrojtur, duke besuar se ekzistojnë ushtrues të funksioneve në fushën e të drejtave të njeriut të cilët punojnë në mënyrë të pavarur, profesionale dhe të paanshme, dhe para vetes e kanë vetëm fjalën e ligjit dhe drejtësisë.

Duke Jua uruar këtë ditë, dua të apeloj për objektivitet dhe transparencë më të madhe të organeve ndaj qytetarëve në kërkimin e tyre për drejtësi, e cila mund të jetë e ngadaltë, por nuk është e verbër.

Ju faleminderit!

